



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



9-15 QERSHOR

JAVA E MBROJTJES

MBYLLET ME SUKSES “DEFENDER EUROPE 25”

Stërvitja shumëkombëshe “Defender Europe 25” u përmbyll me një **ceremoni** të veçantë, të organizuar në Ditën e Vizitorëve të Shquar. Në **aktivitet** morën pjesë **personalitete** të larta nga Shqipëria dhe partnerët ndërkombëtarë. Të ftuarit ndoqën disa nga **demonstrimet** e **trupave** në kuadër të kësaj stërvitjeje.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



LABORATORI NË SPITALIN E TRAUMËS

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, shoqëruar edhe nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjenerallejtënant **Arben Kingji** inspektoi **laboratorin** ushtarak në Spitalin e Traumës. Investimi **përfundoi** në mesin e vitit 2024 dhe sot laboratori ushtarak i Spitalit të Traumës ofron shërbime për mbi **75 mijë** persona që **përfitojnë** nga Status i Ushtarakut.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

AMBASADORI I SPANJËS NË SHTËPINË E MBROJTJES

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, priti në një takim Ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri, Gabriel Cremades Ventura. Gjatë bisedës, u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe angazhimet në kuadër të NATO-s.

JM



mod.gov.al



STËRVITJE PËR REAGIMIN NDAJ ZJARREVE MASIVE

Për dy ditë me radhë, 11-12 qershor, në zonën e Gërhotit në Gjirokastër u zhvillua stërvitja funksionale (CPX) “Reagimi ndaj zjarreve masive 2025”, e organizuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), në bashkëpunim me Bashkinë dhe Prefekturat e Qarqeve Gjirokastër dhe Vlorë, me angazhimin e të gjitha strukturave të mbrojtjes civile të të dy qarqeve. Drejtori i AKMC Haki Çako tha se, kjo është një stërvitje e fokusuar në marrjen e masave për zjarret.

★★★★★

APLIKIMET PËR USHTARË DHE DETARË AKTIV

Qendra e Personel Rekrutimit ka nisur regjistrimin e kandidatëve për ushtarë dhe detarë aktiv në Forcat e Armatosura. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 29 gusht 2025. Për më shumë informacion mbi kriteret, dokumentacionin e nevojshëm dhe procedurat e aplikimit, vizitoni faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



FA E ANGAZHUAR NË SHUARJEN E ZJARREVE

Zjarri që përfshiu një sipërfaqe pyjore në **Qeparo** këtë javë u shua **plotësisht** vetëm disa orë pas ndërhyrjes së menjëhershme nga toka dhe **ajri**. Në aksion u përfshi edhe helikopteri **Black Hawk** i Forcës Ajrore e mjetet zjarrfikëse, të cilat shmangën dëmet në **banesa** dhe në një fabrikë vaji.



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI PRITI USHTARAKËT E LARTË

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në **takim** zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade **LaPoint** dhe zëvendësdrejtorin e Planifikimit të Komandës së Forcave Amerikane për Evropën (USEUCOM), gjeneral brigade **McKinney**. Vijimi i bashkëpunimit dypalësh me fokus stërvitjet dhe trajnimet e përbashkëta ishin disa nga **çështjet** që u diskutuan në takim.

★★★★★